



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:043692

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06288819

KF.nr.565/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit D.P.H., “Large Bar” A.H. B.I., me numër unik identifikues 810913526 dhe me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi-ndëshkim administrativ, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të paditësit, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur me datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit D.P.H., “Large Bar” A.H. B.I., me numër unik identifikues 810913526 dhe me seli në Prishtinë, si e pabazuar.
- II. MBETET NË FUQI vendimi nr.377/2021 i datës 27.10.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më datë 03.03.2022, ka inicuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit jo të drejtë të drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative. Sipas paditësit, gjatë vizitës së zyrtarëve të ATK-së, si dhe një ditë më herët, kanë pasur probleme me arkën fiskale për shkak të vonesës në printimin e kuponëve fiskal, gjë që, sipas tij, nuk është në përgjegjësinë e tij, por e Operatorit Ekonomik të licencuar dhe të autorizuar nga i padituri. Paditësi gjithashtu ka theksuar

se, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale (PEF), kishte njoftuar Operatorin Ekonomik për mirëmbajtjen e arkës fiskale. Një ditë më herët, Operator Ekonomik kishte ekzaminuar arkën fiskale dhe kishte lëshuar një Raport Pune, ku ishte përshkruar problematika me komunikimin e PC-së dhe bllokimin e portit. Megjithëse ishte bërë një ndërhyrje për të rregulluar problemin, këto defekte u përsëritën të nesërmen. Padiësi ka theksuar se Raporti i Punës i Operatorit Ekonomik, i datës 15.07.2021, e përmend qartë problemin me komunikimin e PEF-it dhe bllokimin e portit të komunikimit në PC. Gjendja faktike është pasqyruar edhe në Raportin e Vizitave Përmbushëse të inspektorëve të ATK-së, ku është vërejtur se numri i kuponëve fiskalë të regjistruar u rrit nga 78 në 104 për shkak të deblokimit të portit. Këto kuponë, të regjistruar më parë si furnizime me PEF nga padiësi, u printuan menjëherë pas deblokimit të portit në momentin e vizitës së inspektorëve. Ky fakt, sipas padiësit, nuk u mor parasysh nga inspektorët, edhe pse ishin të informuar për këtë problem teknik. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohet vendimi i Divizionit të Ankesave të ATK-së nr. 377/2021, datë 27.10.2021, ose lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura, në përgjigjen ndaj padisë të datës 09.08.2024, i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga padiësi, duke i vlerësuar ato si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale. Sipas ATK-së, vendimi i kontestuar i Divizionit të Ankesave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ka shtuar se, gjatë vizitës së inspektorit më datë 16.07.2021, ishte konstatuar se padiësi nuk kishte lëshuar kuponë fiskalë për dyzet e gjashtë tavolina, gjë që përbënte shkelje të dispozitave ligjore në fuqi. Tutje thekson se përdorimi i arkës fiskale dhe lëshimi i kuponëve fiskalë është i përcaktuar qartë në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2015, i ndryshuar dhe i plotësuar me UA nr. 02/2018, që është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Ky nen parashikon që printimi dhe dorëzimi i kuponëve fiskalë është i detyrueshëm në momentin e regjistrimit të furnizimit në pajisjet elektronike fiskale (PEF). Gjykatës i ka propozuar që vendimi i Departamentit të Ankesave të mbetet në fuqi.

Gjykata e ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ në përputhje me dispozitat e nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palëve ndërgjyqëse. Pala padiëse e ka pranuar ftesën për këtë seancë më 19.09.2024, por mungesën e saj nuk e ka arsyetuar. Ndërkohë, pala e paditur përmes parashtresës së datës 03.10.2024 ka njoftuar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancë, duke kërkuar nga gjykata të veprojë në përputhje me nenin 38, paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 07.10.2024, ka administruar provat dhe atë: Ankesë e paditësit në Divizionin e Ankesave në ATK-së e datës 27.09.2021, Vendimi i kontestuar nr.377/2021 i datës 27.10.2021, Vendimi i Zyrës për gjoba dhe ndëshkime administrative nr.prot.1329/2021 i datës 01.09.2021, Njoftim vlerësimi i datës 01.09.2021, Raport i punës me nr.006678, Kuponi fiskal nr.0754, Formë për vizitat përmbushëse e datës 16.07.2021 dhe fatura F0121-08-00003.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative me datë 01.09.2021, ka marrë vendim nr.1329/2021 mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ në vlerë prej 5,000.00 €, për subjektin tatimor këtu paditësin, për shkak të mos lëshimit të kuponëve fiskal në vlerë prej $20 \times 250.00 = 5,000.00$ €. Jo kontestuese është edhe fakti se tatimpaguesi këtu paditësi ka parashtruar ankesë nr.377/2021 me datë 27.09.2021 në Divizionin e Ankesave, kundër vendimit nr.1329/2021 të datës 01.09.2021 nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative. Po ashtu jo kontestuese mbetet edhe fakti se Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave me datë 27.10.2021 ka marrë vendimin nr.377/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 03.03.2022, ka iniciuar këtë kontestin tregtar – administrativ. Kontestuese mbetet nëse pretendimet e paditësit lidhur me mosfunksionimin e PEF ishin të drejta dhe të dëshmuara nga paditësi.

Gjykata, pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka arritur në përfundimin se e paditura ka vepruar në përputhje me detyrimet e saj ligjore. Paditësi, megjithëse ka paraqitur pretendime në lidhje me vonesat në printimin e kuponëve fiskal dhe problemet teknike të pretenduara me PEF-in (Pajisjen Elektronike Fiskale), nuk ka arritur të ofrojë dëshmi të

mjaftueshme që provojnë se këto probleme kanë vazhduar në ditët në vijim. Gjithashtu, pretendimi për printimin e menjëhershëm të kuponëve pas deblokimit të portit nuk e ka dëshmuar me asnjë provë të vetme.

Në këtë kontekst, gjykata vëren se paditësi nuk ka ofruar prova të tjera që të dëshmojnë se ka pasur probleme të mëtejshme ose që printimi i kuponëve nuk është realizuar në mënyrë të drejtë pas deblokimit të portit. Përkundrazi, e paditura ka vepruar brenda kornizës së saj të kompetencave dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme për të vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Nuk është vërtetuar që pretendimet e paditësit për defekte teknike të vazhdueshme të jenë të bazuara në fakte apo prova të qarta.

Gjykata nga raporti i punës i cili është lëshuar më datë 15.07.2021 konstaton se i njëjti përmban konkluzion se Pajisja Fiskale tani është në rregull dhe funksionale, pra pas rregullimit nga operatori përgjegjës. Ditari i arkës i paraqitur nga paditësi në vlerë totale prej 836,00 euro si qarkullim total ditor i shtypur në 23:00h për gjykatën është provë e pamjaftueshme, sepse përfshinë periudhën pas përfundimit të vizitës nga e paditura e që sipas formës së vizitës përmbushëse koha e përfundimit të vizitës nga e paditura është 22.30 h e me të cilën është konstatuar se ditari i arkës i shtypur në kohën e cekur është 796 euro me gjithsej 104 kuponë fiskal. Po ashtu pretendimi i paditësit se pengesat kanë vazhduar edhe ditën pas rregullimit të PEF, për gjykatën është i pabazuar në prova, kjo për faktin se nuk është dëshmuar se i njëjti ka njoftuar operatorin për përsëritje të pengesave në funksionimin e PEF.

Bazuar në këtë, gjykata arrin në përfundimin se e paditura ka vepruar drejtë dhe në përputhje me ligjin, dhe paditësi nuk ka arritur të dëshmojë se ka pasur ndonjë shkelje të vazhdueshme ose të pakorrigjuar të dispozitave ligjore që rregullojnë përdorimin e PEF-it.

Neni 43, par 1. i LKA-së, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L222 .

Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat , Gjykata konform nenit 43, par 1, dhe nenit 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.565/22, datë 07.10.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.